



Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Komuna Zveçan shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

| | |
|-----------------------------------|---|
| Emri i grupit | Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm |
| Titulli i pozitës së punës | Arkëtar |
| Klasa e pozitës | Profesional 3 |
| Koeficienti/Paga | 3.86 |
| Nr. i kërkuar | 1 |
| Data e njoftimit | 24/11/2023 |
| Afati për aplikim | 25/11/2023 - 24/12/2023 |
| Institucioni | Komuna Zveçan |
| Departamenti | Departamenti i Administratës së Përgjithshme dhe Personelit |
| Divizioni | Qendra e shërbimit për qytetarët |
| Vendi i punës | Departamenti i Administratës së Përgjithshme dhe Personelit |
| Nr. i Referencës | RN00012860 |
| Kodi | RPC0006399 |



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Menaxhon dhe mirëmbanë të gjitha transaksionet e parasë së gatshme në institucion;
2. Mbledhja e parave publike në pajtim me Ligjin dhe nënshkrimi i dëftesave sipas nr. Serik të unirefave;
3. Përgaditja e raportit ditor, hyrjeve dhe daljeve të taksave Komunale;
4. Kujdest për sigurinë e të gjitha parave të gatshme në institucion;
5. Përgaditë raportet e parave të gatshme-imita dhe përgatit raportet lidhur me gjendjen e arkës;
6. Pranimi i pagesave nga zyret e vendit në Bashkësit Lokale dhe zbrazja e tyre;
7. Dorëzimi i parave të grumbulluara në bankë për çdo ditë si dhe sistemon dokumentacionin në regjistrat përkatës;
8. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mundë të kërkojnë në menyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrsi.

2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimin të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku tri (3) vite të studimeve, Fakulteti Ekonomik;
- **Kualifikime të posaçme formale:** Nuk ka;
- **Përvoja e punës e kërkuar:** s'kërkohet përvojë pune.

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Njohuri profesionale specifike në fushën përkatëse të punës, të fituar përmes arsimimit dhe trajnimeve bazike;
- Aftësi për të kuptuar dhe zbatuar praktikat operative për të përmirësuar efikasitetin;
- Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të caktuar;
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point).



5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore (personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë vërtetimin e nostrifikimit të diplomës apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë);
- Kopjet e dokumentit personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Kopjet e dëshmisë së punësimit;
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- Certifikata nga gjykata kompetente që dëshmon se nuk jeni i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje (jo më e vjetër se 6 muaj);
- Certifikatë shëndetësore që dëshmon se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore (dorëzohet para emërimit në pozitë);
- Dokument që dëshmon se nuk keni në fuqi ndonjë masë disiplinore për shkelje të rëndë (nese aplikuesi ka punuar ose punon në institucione publike).

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 08/01/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Kriteret specifike shtesë

//

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

//

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

